



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 32/2 Prot.

Tiranë, më 25 . 01 . 2023

**V E N D I M**

**Nr. 17, Datë 25 . 01 . 2023**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 9 Regj., datë 11.01.2023, të shtetases A. D, kundër Ministrisë së Mbrojtjes, me objekt pretendimin e diskriminimit në fushën e punësimit, për shkak të “*bindjeve politike*”, “*gjinisë*” dhe “*gjendjes arsimore*”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**KONSTATOI:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, A. D, në parashtrimet e sjella para Komisionerit shprehet se: “*Jam një ish-punonjëse e Ministrisë së Mbrojtjes, ku kam punuar mbi 5 (pesë) vite në fushën e medias së shkruar, që nga viti 2014 deri në 2019. Në vitin 2019 jam larguar nga puna në mënyrë të pamotivuar dhe pa shkaqe të rëndësishme, siç parashikohet në ligj, gjë që duket edhe në vendimin e largimit nga puna të nënshkruar nga ministrja Olta Xhaçka, pasqyruar edhe në Librezën e Punës. Aktualisht jam e papunë, prej 4 (katër) vitesh*”.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

Subjekti ankues ka pretenduar se është diskriminuar nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes gjatë marrëdhënies së punës, për shkak të bindjeve politike dhe të gjinisë së saj, duke argumentuar si më poshtë citohet:

*“ Në rastin tim ky është një diskriminim i tërthortë, për shkak të bindjeve politike dhe përkatësisë gjinore. Këtë e provon edhe urdhri i largimit tim nga puna, i cili nuk mbështetet në asnjë motivacion dhe nuk citon asnjë shkak të arsyeshem të largimit tim. Kjo provon se shkaqet e vërteta të largimit tim janë:*

- *Bindjet e mija politike të cilat nuk i kam shfaqur në vendin e punës, si dhe veprimtaria ime si mbështetëse e Partisë Fryma e Re Demokratike, që nga themelimi i saj e në vazhdim, por gjithmonë jashtë orarit zyrtar dhe në ditët e pushimit, sipas parashikimeve ligjore. Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2013, unë kam përfaqësuar këtë parti si kandidatë për deputete, në qarkun e Dibrës.*
- *Përkatësia gjinore, duke pasur parasysh se, në Ministrinë e Mbrojtjes, sipas statistikave, numri i të punësuarve me përkatësi gjinore femra është më i vogël se numri i të punësuarve meshkuj, duke konsideruar ndoshta Ministrinë e Mbrojtjes si një vend pune që kërkon më tepër karakter mashkullor. Ky diskriminim duket në faktin se në këtë Ministri në poste drejtuese ka më shumë meshkuj se femra, duke i konsideruar ato me karakter të dobët, pavarësisht shkollimit apo përvojës së tyre drejtuese të mëparshme, siç është rasti im. Me gjithë kualifikimet e përvojën time si drejtuese, përsëri jam ndier e diskriminuar dhe e shpërfillur edhe gjatë pesë viteve që kam qenë në punë në këtë Ministri dhe më pas. Asnjëherë nuk jam trajnuar në kualifikimet e brendshme dhe të jashtme gjatë kohës që isha e punësuar në këtë institucion megjithëse e kisha kërkuar një gjë të tillë. Madje edhe kur kam konkuruar për një pozicion pune për gritje në detyrë, dhe për të fituar statusin e nëpunësit civil, jam penguar në të gjitha format e mënyrat, përfshirë edhe keqinformimin e bullizimin për të më skualifikuar nga konkurimi”.*

Ankuesja ka pretenduar se është diskriminuar në mënyrë sistematike nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, drejtueses dhe punonjësve të këtij Institucioni, përmes sajimit të inskenimeve të rëndomta e vulgare karshi saj.

Ajo ka pretenduar gjithashtu, se nga ana e ish-punëdhënësit është diskriminuar duke i mbajtur pa të drejtë e në mënyrë arbitrare pagën për 5 (pesë) vite, për llogari të një zyre përmbarimore, fakt i cili lidhej me një kredi personale të marrë prej saj në një banke të nivelit të dytë në Shqipëri.

Ajo ndër të tjera, shpjegon se sipas një llogarie të përafërt të saj, vetëm nga Ministria e Mbrojtjes i janë mbajtur nga paga në mënyrë të padrejtë gati 1.6 milionë lekë në një kohë kur kredia e saj ishte gjithsej 800 mijë lekë, duke pretenduar se i është mbajtur 50% e shumës së kredisë së saj (duke pretenduar se Ministria i ka llogaritur interesin me 50%).

Në përfundim të ankesës së saj, A. D shpjegon se, pavarësisht kualifikimeve të saj të shumta universitare e pasuniversitare, përvojës së saj disavjeçare në fushën akademike, mësimdhënie,

punë kërkimore-shkencore, përvojën në aspektin drejtues institucional, sërish ajo dhe pse ka aplikuar në vende të ndryshme për punë e ka patur të pamundur të gjejë punë.

Ajo është shprehur se: “... kjo situatë absurde dhe kaotike që po rëndon prej vitesh mbi mua dhe familjarët e mi së pari ka të bëjë me ekonominë, por jo vetëm. Janë të përfshirë në këtë situatë të çuditshme të gjithë familjarët e mi, të afërmit, fqinjët, miqtë etj, të cilët janë të gjithë të cënuar, të frustuar, të terrorizuar.

*Përveç Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Shëndetësisë, Bashkisë Tiranë, në këtë problematikë janë përfshirë edhe Policia e Shtetit, Prokuroria, SPAK-u, Gjykatat, Avokatët, etj. Ndihem e diskriminuar për pjesën e arsimit tim, pasi megjithëse kam aplikuar për punë gjithandej, nuk kam marrë asnjë përgjigje”.*

Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri, që në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese, të konstatojë diskriminim të saj në fushën e punësimit për shkaqet e pretenduara, nga ana e ish-punëdhënësit, Ministrisë së Mbrojtjes.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në deklaratimet e depozituara nga subjekti ankues, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, Komisioneri, konstaton se:

- Të gjitha pretendimet e ankueses për diskriminim gjatë marrëdhënieve të punës si dhe lidhur me momentin e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës me të nga ana e ish-punëdhënësit/Ministrisë së Mbrojtjes, lidhen me periudhën kur ajo ishte në punë, pra nga viti 2014-deri në vitin 2019.
- Subjekti ankues është vënë në dijeni të sjelljes diskriminuese të pretenduar, nga ana e punëdhënësit/Ministrisë së Mbrojtjes, që në muajin qershor 2019<sup>3</sup>, (Urdhër me nr. 952, datë 17.06.2019 të Ministrisë së Mbrojtjes “Për ndërprejen e marrëdhënieve të punës”) kohë kur dhe i është njoftuar urdhri për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

<sup>3</sup> Fakt ky i evidentuar edhe në Librezën e Punës të ankueses. (Me datë 17.06.2019)

- Në kontekst të sa më sipër, **ankuesja ka marrë dijëni për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës (fakt për të cilin dhe pretendon diskriminim), që në datë 17.06.2019. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 11.01.2023**, pra më vonë se dy vite nga marrja dijëni. (Konkretisht më shumë se 3 (tre) vite nga marrja dijëni për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës më Ministrinë e Mbrojtjes).

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijëni për sjelljen diskriminuuese”, ankesa e shtetas A. D, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkualuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Lidhur me pretendimin e ankueses për moskthimin e përgjigjes ndaj kërkesave të saj për punësim, Komisioneri vlerëson si më poshtë:

Subjekti ankues është shprehur se ka paraqitur kërkesa gjithandej, ndërkohë që nuk ka depozituar pranë Komisionerit asnjë kërkesë, por ka depozituar 3 (tre) kuponë postarë të marrjes së shkresave të saj, nga ana e institucionit të Presidencës, Kryeministrisë dhe Ministrisë së Brendshme, pa bërë të njohur përmbajtjen e tyre.

Së pari, lidhur me sa më lart, ankuesja nuk ka paraqitur asnjë dokument që të mund të dëshmonte se ka depozituar pranë institucioneve konkrete kërkesa apo ka aplikuar për ndonjë pozicion pune specifik.

Së dyti, lidhur me pretendimin se është diskriminuar nga një sërë institucionesh (referuar kuponëve postar, evidentohen: Ministria e Brendshme, Presidenca, Kryeministria) pasi nuk e kanë punësuar, ankuesja nuk ka dhënë asnjë informacion se cilat kanë qenë pozicionet e punës për të cilat ka aplikuar, kur janë shpallur apo datat kur ajo ka aplikuar për secilin pozicion të pretenduar që nuk është punësuar. Pretendimi i ankueses lidhet me mosmarrjen përgjigje të kërkesave të saj nga ana e institucioneve sipërcituar.

Komisioneri vëren se, mosveprimi i tyre ka të bëjë me moszbatimin e shkeljen e dispozitave ligjore të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, dhe kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Komisioneri vlerëson se, lidhur me pretendimin e ankueses, se institucionet sipërcituar, nuk i janë përgjigjur kërkesave të saj; autoriteti mbikëqyrës i pavarur për zbatimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, është institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDHP).

Bazuar në nenin 24, të këtij Ligji, i cili parashikon se: “Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit. Me marrjen e ankesës, KDIMDHP ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila, verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t’u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, Komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve. KDIMDHP merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi. Në qoftë se KDIMDHP nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 4, të këtij neni, ankuesit i lind e drejta për t’iu drejtuar gjykatës. Procedura administrative e parashikuar në këtë nen nuk çënon kompetencat e Avokatit të Popullit, lidhur me mbikëqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile, sipas ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, KDIMDHP, shqyrton kërkesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e pretendimit të shtetases Anila Doda për moskthim përgjigje nga ana e institucioneve, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj<sup>4</sup>.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) .....është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni

---

<sup>4</sup> Për analogji citojmë Vendimin nr. 231, datë 25.11.2021 të KMD-së, Vendimin nr. 256, datë 29.12.2021, të KMD-së, Vendimin nr. 167, datë 22.08.2022, të KMD-së, Vendimin nr. 225, datë 22.12.2022, të KMD-së, etj.

33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë kërkimet e ankueses për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

Për sa më sipër, subjekti ankues mund t’i drejtohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së informimit.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 33, pika 4, shkronjat b) e dh), nenin 33, pika 10, nenin 36, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së shtetasës A. D, për shkak se është jashtë afatit për shqyrtimin e ankesave, sipas parashikimit të dispozitave të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**